

UDHËZIM
Nr. 2, datë 15.3.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE SPECIFIKE PËR AMBALAZHIMIN DHE
ETIKETIMIN E PMB-ve

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 24, pika 4, të ligjit nr. 105/2016, datë 14.10.2016, “Për mbrojtjen e bimëve”,

UDHËZOJ:

- I. Miratimin e rregullave specifike për ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve, si më poshtë vijon:
 1. Lejohet ambalazhimi i PMB-ve, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.
 2. Ambalazhimi i PMB-ve përfshihet në kategorinë II.5.A.1, të shtojcës së ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 3. Ambalazhimi i PMB-ve bëhet nga persona fizikë ose juridikë (subjekte), për ushtrimin e kësaj veprimtarie. Dokumentacioni që provon përmbushjen e kriterëve për ambalazhim është si më poshtë vijon:
 - a) dokumenti i certifikimit nga një trupë certifikuese, e akredituar në përputhje me standardin SSH ISO/IEC 17065;
 - b) diploma e drejtuesit teknik në fushën e kimisë ose agronomisë;
 - c) leja e mjedisit e tipit A, referuar kërkesave të ligjit nr. 10 448, “Për lejet mjedisore”, i ndryshuar;
 - ç) dokumenti i lëshuar nga inspektorati përgjegjës për shëndetësinë, në zbatim të legjislacionit për shëndetin publik;
 - d) dokumenti i lëshuar nga *Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (SHMZSH)*, në zbatim të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.
 4. AKU-ja verifikon dokumentacionin sipas pikës 3 të këtij udhëzimi.
 5. Ambalazhuesi i PMB-ve, të ketë drejtues teknik, i cili të kryejë funksionet si më poshtë vijon:
 - a) të ushtrorë veprimtarinë e tij bazuar në kontratën e punës me kohë të plotë;
 - b) të ndjekë dhe të kontrollojë të gjitha fazat e procesit të ambalazhimit të PMB-ve;
 - c) të mbajë dokumentacionin teknik dhe ta vejë në dispozicion të AKU-së për 5 vjet, pasi PMB-ja është ambalazhuar dhe vendosur në treg.
 6. Ambalazhuesi i PMB-ve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ka për detyrë të:
 - a) shënojë tek etiketa e PMB-së emrin dhe adresën e subjektit që kryen ambalazhimin e PMB-ve;
 - b) datën e ambalazhimit;
 - c) datën e prodhimit të PMB-së, e cila duhet të përkojë me datën e prodhimit të deklaruar në etiketën e lotit të PMB-së së importuar ose datën e deklaruar në certifikatën e cilësisë që shoqëron lotin e PMB-së së importuar;
 - ç) datën e skadencës së PMB-së (sipas dokumentacionit të regjistrimit);
 - d) vendosë numrin e serisë të PMB-së të prodhuar;
 - dh) regjistrojë në një regjistër të veçantë sasi të PMB-ve të ambalazuara sipas serive përkatëse;
 - e) ketë autorizim nga prodhuesi i PMB-ve, në rastin e ambalazhimit të PMB-ve të importuara nga vetë ambalazhuesi, si dhe autorizim nga prodhuesi i PMB-ve dhe aktmarrëveshje me importuesin në rast se ambalazhimi kryhet për të tretë.
 7. Në zbatim të kërkesës sipas shkronjës “e”, të pikës 6, të këtij udhëzimi, ambalazhuesi i PMB-ve, që do të ambalazhojë PMB-të në Shqipëri, të paraqesë te Drejtoria Rajonale e AKU-së ku ambalazhuesi kryen aktivitetin, një kopje të autorizimit të kompanisë prodhuese të PMB-ve dhe një kopje të aktmarrëveshjes me importuesin. Autorizimi dhe aktmarrëveshja të jenë të noterizuara në gjuhën shqipe.

8. Inspektimi dhe kontrolli për cilësinë e PMB-ve të ambalazuara, lidhur me plotësimin e kërkesave ligjore për tregtim, kryhet nga AKU-ja, në magazinat e ambalazhuesit të PMB-ve në bazë të planit kombëtar të inspektimeve me bazë risku dhe marrjes së mostrave, të miratuar nga ministri, si dhe në bazë të rasteve të parashikuara nga legjislacioni i posaçëm në fushën e inspektimit.

9. AKU-ja pezullon përkohësisht licencën e ambalazhimit të PMB-ve në rastet, kur:

a) kërkohet nga vetë subjekti;

b) gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat sipas përcaktimeve të pikave 1, 3, 5 dhe 6 të këtij udhëzimi.

Në rast se shkeljet e konstatuara sipas shkronjës “b” të pikës 9, nuk plotësohen sipas afateve të vendosura në aktkonstatim, AKU-ja i propozon ministrit revokimin e licencës së ambalazhimit të PMB-ve.

10. Kundër vendimit për pezullimin e përkohshëm të licencës së ambalazhimit të PMB-ve, mund të bëhet ankimim te titullari i AKU-së, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për vendimin. Afati i shqyrtimit të ankesës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike. Kundër vendimit ose pas kalimit të afatit të marrjes së vendimit bëhet ankim në Gjykatën Administrative sipas ligjit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

11. Kundër vendimit për revokimin e licencës së ambalazhimit të PMB-ve, mund të bëhet ankimim te ministri, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për vendimin. Afati i shqyrtimit të ankesës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike. Kundër vendimit ose pas kalimit të afatit të marrjes së vendimit bëhet ankim në Gjykatën Administrative sipas ligjit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

12. Subjektet që ushtrojnë aktivitetin e ambalazhimit të PMB-ve, duhet të plotësojnë kriteret e ushtrimit të aktivitetit sipas këtij udhëzimi brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e udhëzimit.

II. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca